

RAPORTI I PËRKOSSHËM 2 20 prill - 11 maj 2016

13 maj 2016

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Koalicioni i Organizatës Revolucionare të Brendshme Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas dhe dy partive joparlamentare dorëzuan listat e kandidatëve për të garuar në këto zgjedhje. Tri parti tjera që janë nënshkruese të Marrëveshjes së Përzahinos bëjnë thirrje për shtyrjen e zgjedhjeve.
- Atmosfera politike në vend mbetet e tensionuar. Përderisa opozita dhe disa organizata të shoqërisë civile kërkojnë anulimin e zgjedhjeve dhe thirrjen për inkuadrim të shtuar të komunitetit ndërkombëtar në zgjidhjen e krizës, kundër-protestat thirrjen që zgjedhjet të mbahen më 5 qershor.
- Të gjitha protestat janë në përgjithësi të qeta, por u bënë disa arrestime për dëme që u janë shkaktuar godinave shtetërore dhe përmendoreve. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR ka pranuar pretendime të besueshme të presionit të ushtruar mbi punonjësit në sektorin publik për të marrë pjesë në kundër-protestat, por megjithatë, nuk janë ngritur ankesa zyrtare për këtë.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vazhdon punën e vet në një ambient shumë të tensionuar politik. Që nga 15 prilli, dy anëtarët e emëruar nga LSDM nuk kanë marrë pjesë në seancat e KSHZ. Edhe krahas obligimit ligjor për t'u takuar publikisht, KSHZ ka mbajtur dy seanca të mbyllura për publikun, dhe vendimet e tij nuk janë publikuar në mënyrë sistematike në ueb faqen e tyre. Shumë zyra rajonale të KSHZ janë ankuar për mungesën e resurseve dhe mbështetjen e pamjaftueshme nga selia.
- Më 28 prill, KSHZ emëroi anëtarë të ri në Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), duke siguruar përfaqësimin minimum gjinor dhe etnik, të kërkuar me ligj. Nga katër partitë kryesore në parlament, si duket, vetëm partia në pushtet ka emëruar anëtarët e vet në Këshillet Zgjedhorë (KZ). Pasi një numër i madh i KKZ-ve ende nuk janë funksionale, emërimi i anëtarëve të KZ po shtyhet edhe për disa ditë.
- Parregullsitë e pretenduara në listën e votuesve, siç janë votuesit fiktivë dhe praktikatat tjera të mashtrimit shfrytëzohen si argumente kryesore për shtyerjen e zgjedhjeve. Raporti i Progresit i KSHZ lidhur me azhurnimin e listave të votuesve deri më tani nuk ka zbuluar prova për mashtrime në regjistrimin e votuesve.
- Diku 1.8 milionë votues kanë mund të kontrollojnë në mënyrë elektronike vetëm të dhënat e tyre, por jo dhe të qytetarëve tjerë, ashtu siç parashihet me ligjin. KSHZ nuk ka publikuar listat e votuesve në internet, për arsye të vendimit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me ankesën e KSHZ, mbetet që Gjykata Administrative të vendos në lidhje me këtë lëndë.
- Raporti i parë i vëzhgimit i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka konstatuar se transmetuesit privat *Allfa*, *Kanall 5*, *Kanall 5+*, *Sitell* dhe *Nova* deri më tani kanë

dështuar në transmetimin e përfshirjes objektive, të drejtë dhe të paanshme. Ai më tej konstaton se katër mediat e para të numëruara më lartë kanë koordinuar politikën e tyre redaktuese.

- Raporti paraprak i OSBE/ODIHR mbi vëzhgimin e të dhënave të mediave tregon se transmetuesi publik *RTM-1* deri më tani ka ofruar informacione të kufizuara lidhur me ngjarjet politike. Transmetuesit publik *RTM-2* dhe *Alsat-M* kanë ofruar përfshirje më të madhe për partitë shqiptare. Ndërkaq, transmetuesit privat *Sitell*, *Kanall 5* dhe *Allfa* shfaqin anshmëri për VMRO-DPMNE dhe kundër LSDM, ndërsa transmetuesit privat *Tellma* dhe *Vesti 24* janë më të balancuar.
- Deri më tani nuk janë ngritur ankesa zyrtare përpara KSHZ ose gjykatave. Disa institucione shtetërore kanë vendosur linje telefonike për denoncim të cenimeve zgjedhore.

II. KONTEKSTI POLITIK DHE AMBIENTI PARA FUSHATËS

Atmosfera politike në vend mbetet të jetë e tensionuar. Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) mban qëndrimin se mbajtja e zgjedhjeve me 5 qershor është rrugëdalja e vetme nga kriza politike aktuale, ndërsa Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë (LSDM) fton për shtyerjen e zgjedhjeve deri në implementimin e Marrëveshjes së Përzahinos. Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) kanë kumtuar se ata janë për zgjedhje përfshirëse me të gjitha partitë që marrin pjesë.

Shumë nga bashkëbiseduesit e MVZ të OSBE/ODIHR ftojnë për inkuadrim të shtuar të komunitetit ndërkombëtar në zgjidhjen e krizës. Përpjekja e 22 prillit e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara për të ndërmjetësuar krizën politike u prit nga LSDM me deklaratën se ata nuk do të marrin pjesë përderisa nuk tërhiqet falja e presidentit lidhur me skandalin e përgjimeve dhe përderisa zgjedhjet nuk shtyhen. Diskutimet vazhdojnë, pasi ka kaluar afati i fundit i 11 majit për emërimin e kandidatëve, dhe një numër i madh i partive nuk do të marrin pjesë, duke përfshirë këtu LSDM, BDI dhe PDSH.

Protestat dhe kundër-protestat vazhdojnë në Shkup dhe në shumë qytete tjera. Lëvizja qytetare *Protestiram* (Protestoj) kryesisht fton për shtyerjen e zgjedhjeve, anulimin e faljes së presidentit dhe dorëheqjen e presidentit. Protestat kryesisht kanë qenë të qeta, por megjithatë, janë bërë disa arrestime pasi godina shtetërore dhe përmendore ishin spërkatur me ngjyrë.¹ Edhe pse përfaqësuesit e *Protestiram* mbajnë pavarësinë e tyre nga çdo parti politike, VMRO-DPMNE prapëseprapë pretendon se protestat janë orkestruar nga LSDM. Kundër-protestat e organizuara nga Lëvizja Qytetare për Mbrojtje (GDOM) mbështet pozitën qeveritare, duke ftuar që zgjedhjet të mbahen më 5 qershor.

MVZ i OSBE/ODIHR ka pranuar pretendime të besueshme të ushtrimit të presionit mbi një punonjës në sektorin publik për të marrë pjesë në kundër-protesta, duke përfshirë këtu kërcënime për humbje të vendit të punës, por megjithatë, nuk është ngritur asnjë padi zyrtare deri më tani.² Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR ia kanë mveshur këtë kulturës së ekzistimit të frikës nga ndëshkimi në kompanitë dhe institucionet shtetërore.

¹ Deri më tani, 13 persona janë arrestuar dhe ngarkuar me “pjesëmarrje në turmë me qëllim dëmtimi i pronës”, dhe janë urdhëruar të paguajnë gjithsej 15,000 euro për dëmtim.

² Në dy shembuj të verifikuar, dy punonjës publik janë urdhëruar me mesazh tekstual të marrin pjesë në protestat pro-qeveritare në Shkup. Dy punonjës në sektorin publik në Strugë janë ftuar nga një përfaqësues i VMRO-DPMNE që të shkojnë në kundër-protestat në Shkup më 13 prill. Zëvendësi i Avokatit të Popullit i Manastirit i ka thënë MVZ të OSBE/ODIHR se 20 individë kanë ardhur në zyrë për të pyetur se si t’u përgjigjen kërcënimeve për transferim, ulje të pozitës apo madje dhe ndërprerje të kontratës së punës nga drejtorët në kompanitë dhe institucionet shtetërore, duke kërkuar nga ata që ta përkrahin VMRO-DPMNE në zgjedhjet.

Kodi i ri Zgjedhor mundëson përdorimin e stendave të afishimit dhe paneleve të reklamimit për reklamim politik që nga 20 dhjetori 2015. Megjithatë, shumë komuna si duket, nuk janë të vetëdijshme për dispozitat e reja dhe KSHZ ende nuk ka ndarë hapësirën.³

III. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) filloi përgatitjet administrative për zgjedhjet dhe solli një kalendar zgjedhor me afate të fundit ligjore, si dhe buxhetin për administrimin e zgjedhjeve.⁴ KSHZ ka mbajtur seanca të rregullta me vetëm shtatë anëtarë, pasi që dy anëtarët e emëruar nga LSDM nuk kanë marrë pjesë në seancat publike që nga 15 prilli. Edhe krahas obligimit ligjor, KSHZ ka mbajtur dy seanca pa ftuar mediat dhe vëzhguesit. Veç kësaj, vendimet e tij formale nuk janë publikuar në mënyrë sistematike në ueb faqen e tij.⁵

KSHZ vazhdon punën në një ambient shumë të tensionuar politik dhe me kritikën nga opozita dhe disa organizata të shoqërisë civile, të cilat pretendojnë se nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve më 5 qershor. Organizatat e shoqërisë civile MOST dhe CIVIL kanë kritikuar KSHZ për “dështimin në pastrimin e listave të votuesve” dhe për “dhënien e kushteve për zgjedhje të ndershme dhe të besueshme”.⁶ Në një seancë publike, KSHZ ka refuzuar të gjitha këto pretendime dhe disa nga anëtarët e vet kanë akuzuar të dy organizatat për pasje të lidhshmërisë me LSDM.

Punonjësit në zyrat rajonale të KSHZ që janë vizituar nga MVZ të OSBE/ODIHR, si duket i janë përkushtuar punës së vet, por shumica e tyre janë ankuar për mungesën e resurseve të nevojitura dhe mbështetjes së pamjaftueshme që pranojnë nga selia.

Pasi mandati katër-vjeçar i komisioneve komunale të zgjedhjeve (KKZ) skadoi më 28 prill, KSHZ caktoi anëtarë të ri të KKZ-ve. Seleksionimi u bë sipas rastit, nga mesi i nëpunësve publik, nëpërmjet të një programi kompjuterik. U respektua në masë të madhe përfaqësimi minimum i gjinive dhe etnive, ashtu siç kërkohet me ligj. Në mesin e të seleksionuarve, 47 për qind të anëtarëve të KKZ-ve janë gra.

Si duket, një numër i madh i KKZ-ve nuk është funksional. Pasi caktimi i anëtarëve të tyre nuk ishte harmonizuar me kalendarin e zgjedhjeve të vitit 2016, anëtarët e ri nuk kanë pranuar asnjë trajnim përpara se të fillonin me zbatimin e detyrave të tyre. Veç kësaj, MVZ i OSBE/ODIHR ishte informuar se disa nga anëtarët e ri nuk kanë qenë në dijeni për angazhimet e tyre. Rreth 40 anëtarë të KKZ-ve kanë kërkuar nga KSHZ ta anulojë seleksionimin e tyre për arsye shëndetësore, përkatësi ndonjë partie politike, ose për arsye të mungesës së arsimimit të duhur.⁷

³ Në çdo komunë, 50 për qind të stendave të afishimit mund të shfrytëzohen, nga të cilat 40 për qind duhet t’u jepen partive në pushtet dhe në opozitë, ndërsa 10 për qind partive parlamentare pa grup në parlament dhe partive jashtëparlamentare. Dy kompani marketingu i kanë dërguar KSHZ propozimet e veta për dhënie dhe çmimet, brenda afatit të fundit.

⁴ Buxheti i miratuar përbëhet nga 450 milionë denarë (7.3 milionë euro).

⁵ Neni 54 i Rregullores së Përkohshme të KSHZ kërkon që gjithë aktet që miratohen nga KSHZ, të publikohen në ueb faqen e tij. Kodi Zgjedhor kërkon seancat e KSHZ të jenë publike.

⁶ Shihni deklaratat e [MOST](#) dhe [CIVIL](#).

⁷ Shumë pjesëtarë të stafit rajonal të KSHZ dhe anëtarët e sapo seleksionuar të MKZ që janë kontaktuar nga MVZ të OSBE/ODIHR, kanë mësuar për angazhimet nga ueb faqja e KSHZ ose nga MVZ i OSBE/ODIHR.

Deri më afatin e 5 majit, si duket, nga katër partitë kryesore parlamentare, vetëm VMRO-DPMNE ka emëruar përfaqësuesit e vet në Këshillat Zgjedhore (KZ).⁸ Emërimi i anëtarëve të KZ skadonte ditën e nesërme, por në shumicën e KKZ-ve akoma nuk ishin caktuar KZ.

IV. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Pas një përpjekjeje tremujore për pastrimin e regjistrit të votuesve, parregullsitë e pretenduara, siç janë votues fiktivë dhe praktika tjera të mashtrimit, akoma po shfrytëzohen si një nga argumentet kryesorë për shtyerjen e zgjedhjeve. Raporti i Progresit i KSHZ i 26 prillit mbi azhurnimin e listave të votuesve nuk ka zbuluar prova të mashtrimeve në regjistrimin e votuesve deri më tani.

Pothuajse gjithë 300,000 evidencat parimisht të identifikuar si të kontestueshme, tani janë quajtur të vlefshme. Janë bërë ndryshime të vogla, kryesisht me mënjanimin e personave të vdekur.⁹ KSHZ ka zbatuar një verifikim plotësues të bazave elektronike të të dhënave për rreth 47,000 votues të cilët nuk janë takuar personalisht gjatë verifikimeve të terrenit të zbatuara nga 28 mars deri më 5 prill. Kjo ka çuar drejt ndryshimeve të vogla në regjistër. KSHZ po zbaton hulumtim plotësues të rreth 4,100 votuesve, statusi i të cilëve është vënë në pyetje si rezultat i një verifikimi në internet. Shumë bashkëbisedues të OSBE/ODIHR, duke përfshirë këtu dhe stafin rajonal të KSHZ, kanë ngritur dyshime rreth dobishmërisë së verifikimeve të terrenit në përgjithësi.

Si përgjigje ndaj 45 kërkesave me shkrim të KSHZ, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka dërguar evidenca të verifikuara të qytetarëve. Shumica e këtyre kërkesave ishte nënshkruar vetëm nga zëvendës ministri, pasi ministri, i cili përfaqëson LSDM, kishte refuzuar të nënshkruante, me argumentimin se më tepër kohë është nevojitur për zbatimin e verifikimeve të sakta. Përderisa përfaqësuesit e LSDM në KSHZ vunë në pyetje ligjshmërinë e dokumenteve të tilla, KSHZ vendosi t'i pranonte ato.¹⁰ Veç kësaj, ministri i MPB kërkoi nga KSHZ të largonte rreth 130,000 votues të cilët posedojnë pasaporta, por nuk kanë letërnjoftim të vlefshëm, për të cilët ai kishte pretenduar se nevojitet të provohet vendqëndrimi i tyre. KSHZ refuzoi këtë kërkesë në bazë të asaj se ligji përcaktonte regjistrimin e votuesve ose me letërnjoftim të vlefshëm, ose me pasaportë.

Një shqetësim aktual për KSHZ janë të ashtuquajturit “Votuesit nga Pusteci”: qytetarë këta që jetojnë në Shqipëri, kualifikimi i të cilëve për votim mbetet i dyshimtë, për arsye të statusit të paqartë të vendbanimit.¹¹ Këta persona gjoja janë shtuar në listat e votuesve në komunën Qendër të Shkupit, për të ndikuar rezultatin e zgjedhjeve lokale. Sipas përfaqësuesve të MPB, rreth 349 letërnjoftime janë shfuqizuar për arsye se votues të caktuar nuk gëzojnë të drejtën për t'u regjistruar në vendbanimin konkret.¹²

Ashtu siç kërkohet me ligj, inspektimi publik i listave të votuesve, që përmbajnë rreth 1.8 milionë votues, u zbatua nga 25 prilli deri më 9 maj në 34 zyrat rajonale dhe lokale të KSHZ.¹³ Asnjë ekstrakt nga listat zgjedhore e as bazat e të dhënave nuk u vënë në dispozicion votuesve për t'i kontrolluar të

⁸ KZ përbëhen nga pesë anëtarë (dhe pesë zëvendës) me nga një anëtarë të emëruar nga partitë politike në pushtet, një nga partitë në opozitë dhe tre të zgjedhur sipas rastit nga mesi i punonjësve në shërbimin publik.

⁹ Dy persona janë identifikuar si të regjistruar dy here me numra të ndryshëm amë.

¹⁰ Nenet 46 dhe 47 të Ligjit mbi Qeverinë që u inkuadruan si rezultat i Marrëveshjes së Përzahinos, përcaktojnë se të gjitha dokumentet e MPB lidhur me zgjedhjet duhet të nënshkruhen nga ministri ose nga zëvendësi i tij.

¹¹ Pustec është komuna në Shqipëri ku shumica e këtyre qytetarëve jeton.

¹² KSHZ ka identifikuar 32 persona me vendqëndrim në adresa të hapësirave qeveritare, fetare ose afariste.

¹³ Sipas MPB, nga 31 marsi 2016, janë regjistruar 2,464,925 qytetarë në regjistrin e popullsisë, nga të cilët 1,956,518 kanë qenë mbi moshën 18-vjeçare (rreth 150,000 qytetarë nuk kanë vendbanim ose dokument të vlefshëm identifikimi).

dhënat e regjistrimit të qytetarëve tjerë.¹⁴ Në vend të kësaj, votuesit mund të kontrollojnë vetëm të dhënat e tyre personale. Megjithatë, kjo gjë nuk u zbatua në mënyrë të njëtrajtshme anembanë vendit: përderisa në disa zyra ata do të mund të bënin këtë me numrin e tyre amë, në disa zyra tjera kjo gjë ishte e mundur vetëm me emrin e tyre, adresën dhe numrin e vendvotimit. Që nga 9 maji, 4,700 votues kanë verifikuar saktësinë e të dhënave të tyre.

KSHZ nuk ka publikuar listat e votuesve në ueb faqen e tij, siç kërkohet me ligj, për shkak të vendimit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me të cilin ndalohej publikimi i të dhënave personale të votuesve, ku përfshihet dhe emri, mbiemri, gjinia, adresa, data e lindjes dhe numri i vendvotimit.¹⁵ KSHZ është ankuar për vendimin në Gjykatën Administrative,¹⁶ e cila ende nuk ka sjellë një vendim për këtë lëndë. Më 14 maj, KSHZ patjetër duhet dërguar partive politike listat e votuesve, të cilat më tej do të kenë pesë ditë për të kërkuar ndryshime. Azhurnimi i listës së votuesve planifikohet të përmbyllet më 22 maj.

V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Afati i fundit për dërgimin e listave të kandidatëve ishte 11 maj. Nga katër partitë më të mëdha parlamentare, vetëm koalicioni VMRO-DPMNE dorëzoi listat e kandidatëve. Veç kësaj, dy parti joparlamentare, Lëvizja Nacionale për Maqedoninë dhe Partia Social Demokrate e Maqedonisë, emëruan kandidatët e tyre. Nuk u dorëzuan lista të pavarura nga grupe qytetarësh. KSHZ do të kontrollojë listat për pranueshmërinë e kandidatëve dhe përfaqësimin e kërkuar gjinor. Regjistrimi i kandidatëve do të përmbyllet më 14 maj dhe ankesa ndaj vendimeve të KSHZ për mosregjistrim mund të dorëzohen në Gjykatën Administrative.

VI. MEDIAT

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMA) monitoron mediat e transmetimit gjatë periudhës zgjedhore. Më 28 prill, Agjencia lëshoi raportin e parë, i cili u fokusua në transmetuesit kombëtarë, në të cilin u përfshinë 10 ditët e para të kësaj periudhe. Raporti erdhi në përfundim se transmetuesit privat *Allfa*, *Kanall 5*, *Kanall 5+*, *Sitell* dhe *Nova* kanë dështuar të ofrojnë përfshirje objektive dhe të paanshme të ngjarjeve, siç parashihet me Nenin 61 të Ligjit mbi Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Raporti gjithashtu erdhi në përfundim se katër mediat e para, të numëruara më lartë, kanë koordinuar politikën e tyre redaktuese.¹⁷

Kodi Zgjedhor kërkon nga transmetuesi publik të organizojë debate midis partive në pushtet dhe partive në opozitë. RTM-1 bëri përpjekje për të mbajtur dy debate midis VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH, por vetëm VMRO-DPMNE vendosi të merrte pjesë, dhe vetëm një herë. RTM-1 gjithashtu organizoi një debat midis Opsionit Qytetar për Maqedoninë dhe Partisë Socialiste të Maqedonisë, ku Partia e re Social-Demokrate dhe Partia Demokratike Liberale vendosën të mos merrnin pjesë, edhe pse ishin ftuar.

¹⁴ Neni 48.2 i Kodit Zgjedhor përcakton që votuesi të mund të kërkojë të dhënat për të ose për ndonjë votues tjetër.

¹⁵ Drejtorja ka theksuar se publikimi i listave të votuesve me këtë informacion paraqet shkelje të Nenit 5(1) dhe (4) të Ligjit mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

¹⁶ KSHZ kishte argumentuar se Neni 31.28.d i Kodit Zgjedhor lejon publikimin e listës me emrin, mbiemrin dhe adresën e votuesve në ueb faqen e KSHZ.

¹⁷ [Raporti](#) ka theksuar se TV *Allfa*, *Kanall 5*, *Kanall 5+* dhe *Sitell* “shfaqin mënyrë të njëjtë ose jashtëzakonisht të ngjashme të raportimit, ata procesojnë/vejnë theks në tezën dhe qëndrimet e njëjta ..., ata madje përdorin të njëjtat regjistrime si material ilustrues, gjë kjo e cila tregon për koordinim të caktuar të politikave të tyre redaktuese”, dhe etiketon këtë si “në kundërshtim me parimin e autonomisë, pavarësisë dhe llogaridhënies së redaktorëve, gazetarëve dhe personave tjerë të inkuadruar në krijimin e programeve dhe politikës redaktuese”.

MVZ i OSBE/ODIHR vazhdon monitorimin mediatik kualitativ dhe kuantitativ të tetë kanaleve televizive dhe pesë gazetave ditore.¹⁸ Të dhënat preliminare mbi monitorimin e mediave të MVZ të OSBE/ODIHR për periudhën nga 15 prill deri më 11 maj tregojnë se televizioni publik RTM-1 ua përkushton përfshirjen më të madhe aktiviteteve të qeverisë, pastaj vijojnë raportimet mbi VMRO-DPMNE dhe SDSM. Të gjitha partitë tjera politike kanë pranuar një përfshirje të kufizuar. Shërbimi në gjuhën shqipe i RTM-2 dhe transmetuesi privat *Alsat-M* kanë dhënë më tepër përfshirje të partive politike shqiptare, posaçërisht BDI.

Nga 15 prill deri më 11 maj, stacionet më popullore private *Sitell* dhe *Kanall 5*, së bashku me *Allfa*, kanë prezantuar qasje të ngjashme në përfshirjen e lajmeve, duke i kushtuar më tepër kohë VMRO-DPMNE, LSDM dhe qeverisë. Toni i përfshirjes ka qenë kryesisht pozitiv dhe neutral për VMRO-DPMNE dhe për kundër-protestat, dhe kryesisht negativ për LSDM dhe protestat që ftojnë për shtyerjen e zgjedhjeve. *Tellma* dhe *Vesti 24* deri më tani kanë ofruar përfshirje të barabartë të VMRO-DPMNE dhe LSDM.

Garuesit zgjedhor janë të autorizuar për të furnizuar reklamime të paguara politike gjatë periudhës së fushatës zyrtare. ASHMA ka informuar MVZ të OSBE/ODIHR se gjithsej 107 transmetues kanë publikuar listat e çmimeve, ndërsa 24 transmetues kanë informuar ASHMA se nuk do të shesin reklama politike.¹⁹ Veç kësaj, 7 gazeta dhe 12 ueb portale kanë dërguar listat e tyre të çmimeve.

VII. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

KSHZ akoma nuk ka miratuar një udhëzim për sjellje të vendimeve lidhur me ankesat dhe paditë. Sistemi elektronik për administrimin e rasteve dhe ankesave, që kërkohet nga Kodi Zgjedhor, ende nuk është zhvilluar. Deri më tani nuk janë pranuar ankesa zyrtare as në KSHZ e as në gjykatat.

Janë vendosur linje telefonike nga disa institucione: Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës – që punonjësit në sektorin publik të mund të denoncojnë çdo presion të ushtruar mbi ta e që ka të bëjë me zgjedhjet;²⁰ Avokati i Popullit – për qytetarët të denoncojnë shkelje të të drejtave të tyre të zgjedhjes; dhe Prokuroria Publike – për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile të denoncojnë çfarëdo dyshimi për aktivitet kriminel lidhur me zgjedhjet.

Sipas këtyre institucioneve, shumë pak thirrje janë pranuar dhe asnjëra nuk ka të bëjë me shkelje serioze. Prokuroria Publike ka pranuar 16 pretendime ose ankesa, nga të cilat 2 janë referuar në prokurorinë publike themelore, me udhëzimin që të procedojë urgjentisht dhe të raportojë në përgjigje. Nuk janë gjetur baza të dyshimit për aktivitet kriminel në pretendimet tjera.

VIII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Çështjet ndëretnike nuk paraqesin një faktor të spikatur në krizën politike aktuale. Anëtarët e komuniteteve pakicë dhe partitë që përfaqësojnë ato, posaçërisht shqiptarët etnik, kanë marrë pjesë në

¹⁸ Kjo përfshin transmetuesin publik RTM-1 dhe RTM-2, transmetuesin privat *Sitell*, *Kanall 5*, *Allfa*, *Tellma* dhe *Alsat-M*, si dhe programet e lajmeve qëndrore në *Vesti 24*. Gazetat ditore janë: *Dnevnik*, *Vesti*, *Silloboden Pecat*, *Koha* dhe *Lajm*.

¹⁹ Kodi Zgjedhor përcakton se gjithë mediat që dëshirojnë të shesin reklama duhet ta shpallin listen e çmimeve brenda pesë ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Ky KSHZ shtyu afatin e fundit për shtatë ditë.

²⁰ Ministria u dërgoi letër gjithë institucioneve shtetërore me rikujtim se është i paligjshëm ushtrimi i çfarëdo presioni politik mbi punonjësit shtetërorë, duke kërkuar që gjithë punonjësit të informohen për numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit ku ata mund të denoncojnë çfarëdo presioni politik ose që ka të bëjë me zgjedhjet. Deri më tani nuk janë pranuar asnjë denoncim.

protestat anëmbanë vendit, individualisht, me komunitete tjera dhe si pjesë të Lëvizjes *Protestiram*. Edhe i ashtuquajtura bllok jashtëparlamentar i partive më të vogla shqiptare (LR-PDSH, Rilindja Demokratike Kombëtare dhe BESA) iu bashkëngjijt protestave. Në disa zona siç është Tetova, protesta kishte karakter ndëretnik, me simbolet e shfaqura bashkërisht të flamurit të shtetit, si dhe të simboleve të komunitetit shqiptar dhe të atij rom.

Partitë që përfaqësojnë komunitetin rom dhe organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë të drejtat e tyre shprehen shqetësim tek MVZ të OSBE/ODIHR se komuniteti mund të jetë i lakueshëm ndaj presionit politik dhe të shes dhe blejë vota.

IX. AKTIVITETET E MISIONIT

MVZ i OSBE/ODIHR vazhdoi aktivitetet e tij të rregullta, pra, mbajtja e takimeve me zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të partive politike, me administratën zgjedhore, me përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile dhe me misionet diplomatike. Vëzhguesit afatgjatë nga MVZ të OSBE/ODIHR vazhdojnë vëzhgimin e përgatitjeve zgjedhore në rajonet dhe përgatiten për shpërndarjen e vëzhguesve afatshkurtër. Më 22 prill u mbajt një takim informativ për komunitetin diplomatik dhe organizatat ndërkombëtare. MVZ i OSBE/ODIHR gjithashtu informoi dhe një delegacion të Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Sigurohen përkthime jozyrtare në gjuhën shqipe dhe maqedonase.*